



Prishtinë, 21 nëntor 2008
Kodi ZRRE-së: V_132_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit Nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
2. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_06_2008 “Mbi Raportimin Rregullativ të Ndërmarrjeve të Ngrohjes Qendrore”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I_07_2008 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Çmimeve dhe Tarifave në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009”;
4. Raportimin Rregullativ dorëzuar nga NQ “Termokos” SH.A, Zyrës së Rregullatorit për Energji, që përmban informatat për të ardhurat dhe shpenzimet, për asetet, investimet, informatat teknike dhe për konsumatorë që u realizuan në sezonin e ngrohjes 2007/2008;
5. Aplikimin për tarifa për sezonin 2008/2009 dorëzuar nga NQ “ Termokos” SH.A, Zyrës së Rregullatorit për Energji, që përmban informacione lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e parashikuara, asetet / planin investues, dhe prodhimin e furnizimin e parashikuar të ngrohjes;

Në mbledhjen e mbajtur me datë 21 nëntor 2008, nxori këtë:

VENDIM

1. **Aprovohen të Ardhurat e Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Termokos SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2008/2009**

Në €

R	Të Ardhurat e Lejuara	5,539,432
R _F	Pjesa Fikse e të Ardhurave të Lejuara	425,792
R _V	Pjesa Variable e të Ardhurave të Lejuara	5,113,640

2. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe;
3. Ky vendim hyn në fuqi datën e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda 14 ditëve nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Vendimit i bashkëngjitet Raporti Rregullativ: “Përcaktimi i të ardhurave të lejuara për NQ “Termokos” Sh.A. për sezonin e ngrohjes 2008/2009”.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar